

Informacion

“Mbi blerjen e energjisë elektrike për periudhën 01.02.2015- 28.02.2015”

Ne baze të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 338 date 19.03.2008 “Per miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr. 130 date 03.12.2014 të Entit Rregullator të Energjisë mbi “Procedurat për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes nga operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a (OSHEE Sh.a) dhe “Rregullat dhe procedurat e blerjes nga KESH sh.a. të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin Nr.30, date 23.03.2011, të Bordit të Komisionereve të ERE-s, komisioni i Blerjes së energjisë elektrike, në zbatim të urdherit Nr. 1330 prot, date 22.01.2015 të Administratorit të OSHEE sh.a, Z. Adrian Çela me subjekt “Per krijimin e Komisionit të Blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për periudhën 01.02.2015 – 28.02.2015”, në datat 23.01.2015 deri në 27.01.2015, zhvilloi procedurën e blerjes së energjisë elektrike duke ftuar të marrin pjesë shoqëritë tregtare dhe prodhuese që plotësonin nenin 10 të “Rregullat dhe procedurat e blerjes nga KESH sh.a. së energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj” për të paraqitur ofertat e tyre.

Pas dërgimit të ofertave nga shoqëritë tregtare dhe/ose prodhuese, komisioni i blerjes administroi dhe vlerësoi ofertat e paraqitura prej tyre. Shoqëritë që shprehen interes në datën 26.01.2015 janë si më poshtë:

- 1-Shoqëria GEN-I Tirana shpk
- 2-Shoqëria GEN-I Beograd doo
- 3-Shoqëria GEN-I Athens
- 4-Antix sh.p.k
- 5- Shoqëria AXPO a.g.
- 6- Shoqëria AXPO Albania
- 7-Shoqëria GSA shpk
- 8-Shoqëria EFT AG

Më pas komisioni i blerjes vazhdoi procedurat e vleresimit dhe të negocimit me 8 shoqëritë prodhuese/tregtare që paraqitën interes në procedurën e zhvilluar nga OSHEE sh.a. më datë 26.01.2015 për “Blerje e energjisë elektrike për periudhën 01-28.02.2015”.

Në përfundim të fazave të negocimit dhe me qëllim blerjen e energjisë elektrike të planifikuar për t’u blere nga OSHEE sh.a. për periudhën 01-28.02.2015 prej 188,160 MWh, më datë 27.01.2015 komisioni përcaktoi fituesit:

AXPO d.o.o Beograd, ANTIX sh.p.k, GEN-I Tirana sh.p.k; GSA shpk dhe EFT AG dhe me konkretisht si më poshtë:

1. Shoqeria AXPO doo Beograd:

Periudha: 01.02.2015 - 28.02.2015;
Profili i levrimit: 00.00 - 24:00 (24 ore) CET (ora lokale e Shqiperise), nga e Hena ne te Diele;
Kapaciteti: 6 MW;
Sasia: 4,032 MWh;
Çmimi/njesi: 51.60 Euro/MWh;
Vlera totale: 208,051,20 Euro;
Pika levrimit: Linja Serbi, Mal i Zi, – Shqiperi,
Kapacitetet Siguruar nga AXPO d.o.o. Beograd

2. Shoqeria ANTIX sh.p.k.:

Periudha: 01.02.2015 - 28.02.2015;
Profili i levrimit: 00.00 - 24:00 (24 ore) CET (ora lokale e Shqiperise), nga e Hena ne te Diele;
Kapaciteti: 40 MW;
Sasia: 26,880 MWh;
Çmimi/njesi: 56.90 Euro/MWh;
Vlera totale: 1,529,472.00 Euro;
Pika levrimit: Linja Mal i Zi – Shqiperi,
Kapacitetet Siguruar nga ANTIX sh.p.k.

3. Shoqeria GEN-I Tirana sh.p.k.:

Periudha: 01.02.2015 - 28.02.2015;
Profili i levrimit: 00.00 - 24:00 (24 ore) CET (ora lokale e Shqiperise), nga e Hena ne te Diele;
Kapaciteti: 60 MW;
Sasia: 40,320 MWh;
Çmimi/njesi: 57.15 Euro/MWh;
Vlera totale: 2,304,288.00 Euro;
Pika levrimit: Linja Serbi, Mal i Zi, Greqi – Shqiperi,
Kapacitetet Siguruar nga GEN-I Tirana sh.p.k.

4. Shoqeria GSA sh.p.k.:

Periudha: 01.02.2015 - 28.02.2015;
Profili i levrimit: 00.00 - 24:00 (24 ore) CET (ora lokale e Shqiperise), nga e Hena ne te Diele;
Kapaciteti: 85 MW;
Sasia: 57,120 MWh;
Çmimi/njesi: 57.30 Euro/MWh;
Vlera totale: 3,272,976.00 Euro;
Pika levrimit: Linja Serbi, Mal i Zi, Greqi – Shqiperi,
Kapacitetet Siguruar nga GSA sh.p.k.

5. Shoqeria EFT AG:

Periudha:	01.02.2015 - 28.02.2015;
Profili i levrimit:	00.00 - 24:00 (24 ore) CET (ora lokale e Shqiperise), nga e Hena ne te Diele;
Kapaciteti:	89 MW;
Sasia:	59,808 MWh;
Çmimi/njesi:	57.40 Euro/MWh;
Vlera totale:	3,432,979.00 Euro;
Pika levrimit:	Linja Serbi, Mal i Zi, Greqi – Shqiperi,
Kapacitetet	Siguruar nga EFT AG

Shoqerise EFT AG nuk iu pranua sasia prej 31 MW ne profilin band per shkak te plotesimi te sasise se kerkuar, kurse Shoqerite GEN-I Beograd, GEN-I Athens dhe Axpo Albania u skualifikuan, pasi sasia e energjise elektrike e kerkuar per tu blere nga OSHEE sh.a. per periudhen 01-28.02.2015, u plotesua nga shoqerite e mesiperme me cmim/njesi me te ulet.

Totali i energjise elektrike e ofruar dhe kerkuar per t'u blere nga OSHEE sh.a. per periudhen 01-28.02.2015 eshte 188,160 MWh dhe e konvertuar ne vlere monetare 10,747,766.40 Euro (vlere pa TVSH)

Kontratat e mesiperme do te nenshkruan perpara dates 31 Janar 2015.

Në vijim të kontratave të lidhura, shoqëritë AXPO d.o.o Beograd, ANTIX sh.p.k, GEN-I Tirana sh.p.k; GSA shpk dhe EFT AG do të fillojnë lëvrimin e energjisë elektrike në OSHEE sh.a., sipas kushteve të përcaktuara.

Ky njoftim të botohet në faqen zyrtare të internetit të OSHEE sh.a.

Kryetari i Komisionit

Elton Sevrani